



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:016794  
Datë: 10.07.2024  
Numri i dokumentit: 05921751

C.nr. 205/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Leotrim Gashi, pas vlerësimit të marrëveshjes së palëve të arritur në ndërmjetësim, bazuar në nenin 15 par.1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, me datë 10.07.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me datë 18.06.2024, në lëndën C.nr.205/2024 dhe me numër të ndërmjetësimit Nd.nr. 133/2024.
- II. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- III. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- IV. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.205/2024, me datë 10.07.2024

G j y q t a r i

\_\_\_\_\_  
Leotrim Gashi

Numri i lëndës: 2024:016794  
Datë: 10.07.2024  
Numri i dokumentit: 05921751